

# Nacionale

REDAKTOR: Valon A. Syla  
E-MAIL: valon.syla@gazetaexpress.com  
TEL: 038 542 270 FAX: 038 542 270-2

## S'ka licencim për shkolla private?

Ndonëse regjistrimi i studentëve të rinj nëpër universitetet private ka filluar rreth një muaj më parë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ende nuk ka diskutuar për formimin e Komisionit të ri për licencim, e as nuk e ka autorizuar Komisionin e vjetër për

shqyrtimin e dokumenteve të universiteteve private, të cilat pretendojnë të licencohen nga ministria. Kryetari aktual i Komisionit për licencim në MASHT, Esat Dauti, tha se Komisioni ende nuk është autorizuar nga personat kompetent, në këtë rast nga ministri Agim Veliu,

për shqyrtimin e dokumenteve të institucioneve të arsimit të lartë private. "Një herë ka mbetur ai komision që ka qenë vitin e kaluar, por ende nuk jemi autorizuar për ta filluar procesin e përtëritjes së licencave të universiteteve private" tha Dauti.

# Shqiptarët akuzojnë Sunday

**Muhamed Veliu**

Nga Londra

Artikulli dezinformues i mbushur me mllef mbi Shqipërinë dhe shqiptarët me autor Ardian A. Gill ka gjasa të mbërrijë në gjykatën e lartë londineze, nëse gazeta Sunday Times nuk kërkon falje publike. Klubi londinez i lëvizjes Mjaft përmes kompanisë së njohur avokatore për çështjet e medias Carter&Ruck, i ka dërguar një letër kryeredaktorit të revistës Sunday Times, Robim Morgan.


"Nëse brenda 14 ditëve Sunday Times nuk publikon një falje për artikullin dezinformues me tone të qarta raciste, atëherë klienti ynë Klubi i lëvizjes Mjaft në Londër do t'i drejtohet komisionit ankimor të medias "Press Complaint Commission", duke konsideruar çuarjen e çështjes në gjykatë", thuhet në letërën e përgatitur nga avokatët londinezë. Sipas tyre, artikulli jo vetëm që nuk është i saktë, por mbi të gjitha është diskriminues për të gjithë shqiptarët duke thyer rëndë kodin e etikës së mediave britanike. Ralf Gjoni, drejtor i klubit londinez të lëvizjes Mjaft, tha se kjo lëvizje e shikon artikullin si një përpjekje të keqe dhe të qëllimshme të gazetarit Gill dhe gazetës Sunday Times për të dëmtuar marrëdhëniet e tregtisë dhe biznesit mes Britanisë së Madhe dhe Shqipërisë, njëkohësisht për t'ia nxirë imazhin shqiptarëve që jetojnë në Britaninë e Madhe.

### Reagimi i migrantëve

Balta e hedhur ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve botuar në faqet e gazetës Sunday Times tre javë më parë ngjalli reagime në bllok të shqiptarëve në të gjithë botën, dhe në veçanti komunitetit shqiptar në Britaninë e Madhe.

Masakrimi i imazhit të vendit tonë përmes këtij artikulli është cilësuar nga ata si i paramenduar, me qëllime propagandistike të caktuara dhe nuk është aspak i rastësishëm apo produkt i një pene sharlatane apo një nate vere nën duhmë të gotave të birrës konsumuar nga gazetari me origjinë skoceze, Gill.

Mbi 300 telefonata dhe mesazhe elektronike kanë mbërritur në adresë të kryeredaktorit të revistës Sunday Times Robin Morgan, nga i cili kërkohet një falje publike në faqet e gazetës që



*"They're the Asda of mayhem. After years of being bullied, invaded, ripped off and lied to, the Albanians have grown very good at being frightening. They've taken over the crime in Milan - exporting organised crime to Italy beats selling fridges to Eskimos or sand to Arabs"*

## Avokatët britanikë pranojnë se është thyer kodi i etikës së medias. Lëvizja Mjaft kërkon që Sunday Times të kërkojë falje publikisht ose do ta padisin në gjyq.

ai drejton. Përballë një situatë të tillë e cila minon kryekëput punën e diplomacisë shqiptare në Londër që ka tentuar bërjen e një marketingu të imazhit të Shqipërisë në Britaninë e Mad-

he, ka reaguar edhe ambasada shqiptare në Londër. Kastriot Robo, ambasadori shqiptar në Britaninë e Madhe, në mënyrë zyrtare i është bashkuar indinjatës së shqiptarëve duke i dër-

guar një letër proteste gazetës Sunday Times, pronë e manjatis mediatic Rupert Mardock. Kjo letër është botuar jo e plotë, së bashku me tri letra të tjera indinjate.

### Media britanike

Zemërimi i shkaktuar nga kryeartikulli dhe rëndësia që i ka dhënë media e Tiranës kësaj ngjarjeje, përfshi një proces të mundshëm gjyqësor për lejimin

# Ferizaji rimerr të drejtën e menaxhimit të varrezave

Varreza e qytetit në Ferizaj, prej vitesh i janë lënë stihisë dhe në asnjë pjesë të saj nuk vihet re dora e mirëmbajtjes. Mijëra varre të mbuluara nga ferrat, drizat e barishtet, janë pamje të përditshme buzë rrugës Ferizaj-Gjilan. Në prill të vitit të kaluar Kuvendi Komunal me anë të një vendimi, ia delegoi

përgjegjësinë e menaxhimit të varrezave bashkësisë fetare të komunës. Vendimi obligonte bashkësitë fetare që të hartojnë rregullore për mirëmbajtjen e varrezave, por pas më shumë se një viti, asnjë përpjekje e tillë nuk është bërë. Kryespektori ligjor, Jahir Zuka, thotë se varrezat janë hapësira publike që duhet të

menaxhohen nga komuna, por me dëshirë që të plotësohen standardet, nuk është interpretuar drejt Rregullorja 2000/45 e UNMIK-ut. "Degëtimi i kompetencave tek bashkësitë fetare, nuk është bërë me qëllim të t'i iket përgjegjësisë, por duke menduar në aspektin pozitiv se bashkësitë fetare janë më të

kompletuara në këtë drejtim, atyre u është kërkuar që të hartojnë një rregullore për mirëmbajtjen e varrezave. Kështu që në si Kuvend Komunal kemi menduar se është një ndihmë, mirëpo me formimin e zyrës ligjore, e cila më parë nuk ishte e kompletuar, kemi kuptuar se kjo është kompetencë ekskluzivisht e Kuvendit Komunal", tha Zuka.

# Times



ar: "Hundförgiven", në të cilin fliste për urrejtjen e tij ndaj gjer-manëve.

### Toka e harruar

Shkrimi i titulluar "Toka e harruar nga koha", është publikuar në revistën "The Sunday Times" më 23 korrik dhe jep detaje të vizitës së Gill në Shqipëri. Autori e përshkruan vendin si "Rurutani banditësh dhe hakmarrësish" dhe njerëzit e tij si "të shkurtër e fytyrëqelbur, me një trupngjeshje prej uniseksi e këmbë lehtësisht të harkuara, të ngjashme me këmbët e kuajve të vegjël të Shtelandit".

Gill e përshkruan gjuhën shqipe si të përshtatshme për "kode kriminelësh", duke shtuar: "Ka 4 milionë shqiptarë... tre prej të cilëve jetojnë në vendin e tyre, ndërsa pjesa e mbetur punon jashtë më së shumti në të zehtë". Artikulli i ka inatosur shqiptarët kudo që ndodhen dhe është komentuar nga të gjitha mediat shqiptare.

### Në mbrojtje të autorit

Editori i revistës Sunday Times, Robin Morgan, i doli në mbrojtje artikullit të gazetarit të tij. Ai u shpreh se "Ka pasur gjithmonë reagime për shkrimet e Gillit, qofshin këto për Uellsin, Anglinë apo Gjermaninë. Mendoj se njerëzit i lexojnë shkrimet e Gill qoftë edhe për kënaqësinë e mënyrës së tij të të trajtuarit të gjërave". Ai e përshkruan artikullin si të një shkrimi tipik të thartë, duke shtuar se: "Njerëzit e shohin Gillin për atë çka është, por problemi është se shumë shqiptarë mendojnë se ai ka qenë i padrejtë me vendin e tyre, ndërkohë që anët negative ekzistojnë, janë aty".

### BBC ofendoi himnin

Nuk është hera e parë që mediat britanike nëpërkëmbim imazhin e Shqipërisë në mënyrën më të keqe të mundshme. Tre vjet më parë në valët e gjigantit BBC,

komikja Xho Brand do të tallej me himnin kombëtar shqiptar. Në një dialog mes aktorëve dhe Brand mes tyre e transmetuar direkt, komikja u shpreh "can she fart the Albanian anthem?" A mund ta pjerdhë ajo (e dashura e njerit prej aktorëve) himnin shqiptar? Nuk dihet përse pikërisht himni kombëtar shqiptarë atë kohë u përgjodh në dialogun midis aktorëve dhe komikes, gjë e cila ngjalli reagime të shumta në komunitetin shqiptar në Angli shumë prej tyre ndjekës të rregullt të kësaj telenovele. Reagimi i shqiptarëve detyroi drejtorin e përgjithshëm të BBC Mark Bajford, të kërkonte publikisht ndjesë tre muaj më pas.

# Mbyten tre turistë në Ulqin

## Arben Hyseni

ULQIN – Nga trazimi i valëve të detit të Ulqinit, kanë humbur jetën tre turistë. Njëri prej këtyre është kosovar. Ai është Avnor Sadiku nga Rahoveci. Këtë e ka konfirmuar drejtori i Shtëpisë së shëndetit në Ulqin, Gani Karamanaga. Valët e mëdha të asaj dite kanë rrezikuar jetën edhe të shumë turistëve tjerë.

Karamanaga tregon për ditën kur ka ndodhur aksidenti, ku për rreth 3 orë është trazuar deti nga valët e mëdha. Ai thotë se si pasojë e paku-jdësisë, përveç të riut nga Rahoveci, kanë humbur jetën edhe Goran Lubia, 20-vjeç, nga Kravea dhe Vladimir Serbezovski, 24-vjeç nga Shkupi. Në aksidentin e asaj dite kanë qenë në rrezik që ta humbin jetën edhe gjashtë të rinj tjerë nga Kosova.

Klodie Kryeziu, Remzi Merovci, Dëfrim Pindviku, Dafina Milla dhe Elona e Dafina

Morina, gjithë këta kanë qenë në rrezik që të mbyten.

Këta persona janë dërguar urgjentisht në Spitalin e Tivarit, ku edhe u është ofruar shërbimi mjekësor.

Tash për tash janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe pritet që së shpejti të lëshohen nga spitali dhe t'i kthen bregdetit. "Informacionet që më kanë arritur tregojnë se të gjithë janë shëndosh e mirë edhe që të gjithë të shtunën kthehen në Ulqin për të vazhduar pushimet", u shpreh drejtori Karamanaga.

Drejtori i Shtëpisë së Shëndetit dhe agjencitë e shpëtim-it kanë apeluar tek turistët që të jenë të kujdesshëm gjatë trazimit të detit që vjen si pasojë e çrregullimit të motit. Këto pakujdesi dhe jo respektim i gjendjes alarmante shpesh po shndërrohen në tragjedi.

Që nga fillimi i këtij sezoni turistik, në Ulqin kanë humbur jetën aksidentalisht shtatë turistë.


# Dhunë ndaj burrit

## Në Kosovë ka familje që nuk kanë të bëjë më vetëm me dhunë ndaj grave. Edhe gratë ndohë të përdorin dhunë ndaj burrit.

Dukuria e dhunës në familje është në rritje, ndonëse aktualisht, për dallim nga e kaluara, përveç që ushtrohet dhunë ndaj grave edhe burrat ballafaqohen me këtë dukuri, thanë për KosovaLive zyrtarë që merren me këtë fenomen. Sipas të dhënave të SHPK-së, dhuna në familje ka shënuar rritje, ndërkohë që rajoni i Prishtinës gjatë vitit 2005 prin me numrin më të madh të viktimave të dhunës në familje me 428 raste, rajoni i Prizrenit me 241 raste, rajoni i Pejës me 218 raste, ai i Mitrovicës me 210 dhe rajoni i Gjilanit me 150 raste. Dukuria e dhunës në familje ka qenë prezentë edhe në të kaluarën, mirëpo kjo dukuri, sipas policisë, është mbajtur sekret dhe nuk është paraqitur. Veton Elshani, zëdhënësi i SHPK-së, tha të shtunën për KosovaLive se që nga viti 2003,

kur ka filluar edhe aplikimi i rregullores për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, është shënuar një rritje e dukshme e dhunës në familje. Ndërsa një dukuri e re e cila nuk ka qenë prezent në të kaluarën në familjet kosovare, është dhuna e cila ushtrohet ndaj meshkujve, respektivisht dhuna që ushtrojnë gratë ndaj burrave. Ndërkohë që sociologët këtë dukuri e arsyejnë me faktin se në ato raste burrat shpesh nuk janë të punësuar, ndërsa gratë punojnë dhe burrat në këtë raste ndihen inferior në familje. Sociologu Ilir Rexha tha për KosovaLive se dhuna në familje është e shprehur në çdo shoqëri, por duke e pasur parasysh faktin se shoqëria kosovare po kalon në një fazë tranzitore, dhuna është më e shprehur. Ai tha se në Kosovë janë më të

shprehura disa forma të dhunës, si sulmi seksual dhe fizik dhe një formë tjetër e dhunës e cila është mjaft e shprehur tek kosovarët, që njihet si dhunë verbale e që në të shumtën e rasteve ka të bëjë me poshtërimin dhe nënçmimin. "Edhe pse në Kosovë dhuna është e shprehur në një shkallë të lartë, ajo fatkeqësisht heshtet nga vetë femrat të cilat në të shumtën e rasteve janë viktimat, duke mos përjashtuar edhe meshkujt", tha ai. Ndërkaq shkaktrëjt që shkaktojnë dhunën në familje, në të shumtën e rasteve janë zgjidhja e konflikteve në familje me dhunë, shkatërrimi i strukturave të familjes, rritja në përgjithësi e jostabilitetit dhe joshinjeritetit, por edhe papunësia që në Kosovë është në shkallë të lartë. (KosovaLive)



Photographs by Tom Craig

e një shkrimi me përmbajtje raciste nga gazeta Sunday Times, është pasqyruar edhe në median britanike. Press Gazette e cila lexohet nga njerëzit e medias me detaje, ka raportuar në numrin e fundit të saj rreth ofendimit të Gill ndaj shqiptarëve, duke kujtuar se për Gill kjo nuk është hera e parë që një shkrim i tij ngjall kundërshtime te ashpër.

Në vitin 1997 ai u padit në polici për nxitje të urrejtjes racore, pasi i kishte cilësuar banorët e Uellsit si "të shëmtuar e hundëshytur".

Dy vjet më vonë ai u kritikua sërish për një artikull të titulluar